



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më _____.____.2021

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2021

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022 DHE PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2022 - 2024 TË BASHKISË SË SHKODRËS**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.____.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 34, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; projektligjit "Për buxhetin e vitit 2022", të propozuar nga Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 624 datë 22.10.2021; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, Udhëzimit të Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr. 07 datë 26.02.2021 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 20 datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024””; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit”; Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 18976 datë 29.10.2021 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar dhe specifike, per vitin 2022", dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër

V E N D O S I:

1. Të miratojë buxhetin e vitit 2022 dhe programin buxhetor afatmesem përfundimtar për vitet 2022 - 2024, të Bashkisë se Shkodrës, si më poshtë:
 - a) Të miratojë fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2022-2024 , të ndara në korrente dhe kapitale; sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b) Të miratojë tavanet për çdo program, për vitin 2022 - 2024 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës F2 të FPT (Instrumentit të Planifikimit Financiar) dhe programeve buxhetore te detajuara , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c) Të miratojë të ardhurat sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme, sipas tabelës F1 dhe F2 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- d) Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve në varësi për vitin 2022, sipas tabelës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - e) Të miratojë detajimin e shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2022-2024 sipas tabelës F10 të FPT dhe programeve buxhetore të detajuara sipas klasifikimit ekonomik, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - f) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, sipas tabelës F15 dhe E3 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Tabelat shoqeruese:
 - a) Llogaritja e efektit financiar të lehtësimeve fiskale vendore, tabela nr.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b) Lista e njësive shpenzuese të bashkisë Shkodër, sipas tabelës nr. 4 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c) Një përmbledhje të të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë, sipas tabelës nr. 5 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d) Projektin e parë të planit të arkës të të ardhurave të veta të vitit 2022, sipas tabelës nr. 6 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - e) Një përmbledhje të pagesave të vonuara ndaj palëve të treta, përfshirë edhe origjinën e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre, sipas tabelës nr. 7 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 3. Fondet e papërdorura në fund të vitit 2021, me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike dhe të ardhurat e veta, do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2022.
 4. Është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:
 - a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
 - b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
 - c) Rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Voltana Ademi

Zv. Kryetar

Zv. Kryetar

Zv. Kryetar

Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Drejtoria e Financës

Drejtoria e të Ardhurave

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së
investimeve të Infrastrukturës

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të
Ujërave

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Trajtimit të AMTP

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit,
Koordinimit të Investimeve

Drejtoria e Turizmit

*Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit*

*Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Personave me
Aftësi Ndryshe*

Policia Bashkiake